



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 15 Datë 04/02/2011

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-------------------|-------------|
| - Z. Besjan Pasha | Kryetar |
| - Znj. Anila Jani | Nënkryetare |
| - Z. Altin Goxhaj | Anëtar |

në mbledhjen e tij të datës 04.02.2011, mori në shqyrtimin ankesën e Z. Gëzim Skuka, në lidhje me ndryshimin e normës së interesit, në kundërshtim me “Kontratën e Huas” nr. 3875 date 3.03.2008 dhe “Shtese Kontraten”, të lidhur me Alpha Bank - Albania, Dega Shkodër.

Komisioni konstatoi mungesën e përfaqësuesit të Alpha Bank – Albania, në seancën dëgjimore, të lajmëruar me ane të shkresave nr. prot 33/2, date 1.12.2010, nr. prot 5, date 02/02/2011, si dhe mos kthimin e përgjigjeve të shkresave nr. prot 33/2, date 1.12.2010, dhe nr. prot. 33/3, date 22.12.2010 të Komisionit, ku kërkoheshin informacione dhe sqarime.

Në këto kushte Komisioni shqyrtoi kushtet e Kontratës dhe Shtese Kontratës të sipërpërmendura, ku

VËREN SE:

Kushtet e përcaktuara në pikën 13.1 të nenit 13 të Kontratës së Huas nr. 3875, date 3.03.2008 dhe pikës 9.3 të nenit 9, të Shtesës së Kontratës, konkretisht:

- ***pika 13.1 e nenit 13 të Kontrates së Huase “Ndryshim i normës së interesit dhe komisioneve”***: Banka ka të drejten e ndryshimit periodik, në shtim apo në pakësim, të normës së qëndrueshme dhe e marzhit të normës së interesit pa bashkëpunuar me kredimarrësin. Ndryshimi i mësipërm do të behet në varësi të rrethanave të tregut dhe të kostos së parasë për bankën, pa qene nevoja për ndonjë njoftim tjetër për kredimarrësin. Po kështu banka, ka të drejte të ndryshojë normën e referimit jo vetëm duke aplikuar normat e referimit të një afati tjetër në krahasim me afatin e mëparshëm por edhe duke aplikuar një norme referimi në një monedhe tjetër po qe se gjate administrimit të huas, kredimarrësi ndryshon me miratim të bankës monedhën ekzistuese të huas, dhe
- ***pika 9.3 të nenit 9 të Shteses së Kontrates “Lloji i normës së interesit dhe i monedhës”***: Huaja në pese vitet e para do të jete në EUR dhe me një norme të pandryshueshme (fikse) interesi prej 5,7 %,

paraqesin në menyre të paqarte apo të dykuptimte informacionin, që çorienton dhe mashtron konsumatorin, duke i dhene atij të kuptoje që ndryshimi i normes së interesit sipas pikës 13.1 të Kontrates së Huase mund të ndodhe vetem pas pese viteve të para.

Ky informacion eshte informacion i mangët corientues ne kuptim te nenit 15, pikes 2 te ligjit nr. 9902, date 17.04.2008 “Per mbrojtjen e konsumatoreve”:

- **nenin 15 pika 2:** *“Konsiderohet, gjithashtu, informacion i mangët çorientues kur, duke marrë parasysh përmbajtjen e pikës 1 të këtij neni, një tregtar fsheh ose jep informacion në një mënyrë të paqartë, të pakuptueshme, të dykuptimtë ose të parakohshme, ose dështon në identifikimin e qëllimit tregtar të praktikës së tij tregtare, nëse ajo nuk është e dukshme nga konteksti dhe kur në cilindo rast kjo e bën apo ka mundësi ta bëjë konsumatorin mesatar të marrë një vendim, të cilin, në të kundërt, nuk do ta kishte marrë”.*

Ne keto kushte kjo perben praktike tregtare corientuese, ne baze te ligjit 9902, neni 15, pika 1 dhe neni 14, pika 2:

- **neni 15, pika 1:** *“Një praktikë tregtare është çorientuese kur, duke konsideruar të gjitha tiparet dhe rrethanat e saj, si dhe kufizimet e mjeteve të komunikimit, jep të mangët informacionin, që i nevojitet konsumatorit mesatar për të qenë i informuar për të marrë një vendim dhe, në këtë mënyrë, e bën apo ka mundësi ta bëjë konsumatorin mesatar të marrë një vendim, të cilin, në të kundërt, nuk do ta kishte marrë”*
- **nenin 14 pika 1.:** *“Një praktikë tregtare është çorientuese kur përmban informacion të rremë dhe për rrjedhojë është e pavërtetë. Një praktikë tregtare është çorientuese edhe kur, në çfarëdo mënyre, përfshirë paraqitjen e përgjithshme, mashtron apo ka mundësi të mashtrorë konsumatorin mesatar, duke e bërë ose ka mundësi ta bëjë atë, të marrë një vendim, të cilin, në të kundërt, nuk do ta kishte marrë, edhe kur informacioni është bazuar në fakte të vërteta për një ose më shumë prej elementeve të mëposhtme;.....*

Ne nenin 13 te ligjit 9902, percaktohet se praktikat corientuese jane praktika tregtare ne ndaluara.

Per me teper, pika 13.1 e nenit 13 te Kontratën e Huas nr. 3875, e sipërcituar, përbën një kusht te padrejte, referuar pikës 4 te nenit 27 te Ligjit nr. 9902:

“Janë kushte te padrejta ne kontrata te drejtat e tregtarit kur:

g) i mundësojnë tregtarit te ndryshoje kushtet e kontrates ne menyre te njëanshme, pa një arsye te vlefshme, qe specifikohet ne kontrate, dhe

gj) i mundësojnë tregtarit te ndryshoje ne menyre te njëanshme, pa një arsye te vlefshme, cdo karakteristikete mallit ose sherbimit qe eshte per tú ofruar”,

Per me teper, pika 13.1 e nenit 13 te Kontratën e Huas nr. 3875, e sipërcituar, përbën një kusht te padrejte, referuar pikës 4 te nenit 27 te Ligjit nr. 9902:

Sipas nenit 28 “Kerkesat e transparences” te ligjit 9902:

- **Neni 28, pika 1:** *“Në rastin e kontratave, ku të gjitha ose disa kushte që u ofrohen konsumatorëve janë të shkruara, atëherë këto duhet të paraqiten me një formulim të kuptueshëm. Në rast se ka dyshime rreth kuptimit të kushtit të kontratës, atëherë interpretimi është në favor të konsumatorëve”.*
- **Neni 28, pika 2:** *“Në rastin kur kushti konsiderohet i padrejtë, ai quhet i pavlefshëm nga koha që është lidhur kontrata. Kushtet e tjera kontraktuale mbeten detyruese për palët dhe zbatimi i mëtejshëm i kontratës është i mundshëm”.*

-

PËR KETO ARSYE :

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve mbeshtetur ne nenin 14, pika 1, nenin 15, pika 1 dhe 2, nenin 27, pika 4/g dhe gj, nenin 28, nenin 52, pika 4, dhe nenin 57 pika 2/(a) e (b), te Ligjit nr. 9902, date 17.04.2008 “Per mbrojtjen e konsumatoreve”, si dhe në pikën 6/(b) e (c), dhe 31 të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008.

VENDOSI:

1. Alpha Bank –Albania, te gjobitet me shumën 170.000 leke.
2. Kushti i percaktuar ne Kontraten e Huase ne piken 13.1 dhe ne pika te tjera ne mbeshtetje te ketij kushti, konsiderohet i padrejte dhe shfuqizohet.
3. Alpha Bank – Albania te marre menjëherë te gjitha masat për ndreqjen e shkeljes dhe mos përsëritjen e praktikave te tilla.
4. Te njoftoje menjëherë Komisionin e Mbrojtjes se Konsumatoreve për pagesën e gjobës dhe ndreqjen e shkeljes.

KRYETAR I KOMISIONIT

BESJAN PESHA